



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /  
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo unutrašnjih poslova  
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës  
Polijski inspektorat Kosova  
Police Inspectorate of Kosovo

---

Raport inspektimi Nr: 4/2012

**IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I  
PROCEDURAVE TË ARRESTIMIT/NDALIMIT NË  
POLICINË E KOSOVËS**



**Korrik 2012**

## **SHKURTESAT**

<b>IPK</b>	<b>Inspektorati Policor i Kosovës</b>
<b>PK</b>	<b>Policia e Kosovës</b>
<b>KPPK</b>	<b>Kodi i Procedurës Penale të Kosovës</b>
<b>ZENDPO</b>	<b>Zyra Ekzekutive e Ndhmës Drejtorit të Përgjithshëm për Operativë</b>
<b>PSO</b>	<b>Procedurë Standarde e Operimit</b>

# PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	4
2. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM PËR HAPAT E NDËRMARRA GJATË INSPEKTIMIT.....	6
3. HYRJE.....	7
4. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE NË PËRGJITHËSI.....	9
4.1 Identifikimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë së Procedurave të Arrestimit-Ndalimit të Policisë së Kosovës me KPPK.....	9
4.2 Identifikimi dhe vlerësimi i përmbajtjes së formave zyrtare për arrestim.....	9
4.3 Identifikimi dhe Vlerësimi i zbatimit të Procedurave të Arrestim Ndalimit.....	10
5. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET.....	24
5.1 Përfundimi.....	24
5.2 Rekomandimet.....	25

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Bazuar në autorizimet dhe funksionet që dalin nga Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, Departamenti i Inspektiveve ka ndërmarrë inspektim në fushën e arrestim/ndalimit . Për shkak të ndjeshmërisë që ka arrestimi sepse bëhet fjalë për kufizimin e lirisë së lëvizjes së personit, Inspektorati Policor i Kosovës është vënë në lëvizje në inspektimin e kësaj fushe me qëllim të që të identifikoj dhe vlerësojë çështjet procedurale të arrestim-ndalimit.

1.2 Arrestimi si term juridik që përdoret për të emërtuar veprimin e heqjes së lirisë së personave të akuzuar për vepra penale në bazë të dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës konkretisht sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës është kompetencë e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake. Duke pasur parasysh që me arrestim-ndalim nënkuptohet kapja e personit dhe mbajtja e tij për një kohë deri sa hetimet të tregojnë pafajësinë apo fajësinë e personit të arrestuar, atëherë ky veprim vie në zbatim nga ana e zyrtarëve e që zakonisht janë Zyrtarët Policor nga Policia e Kosovës.

1.3 Bazuar në të gjeturat e inspektimit ka rezultuar se vetëm 32% nga objektivi i caktuar, Kompletimi dhe Harmonizimi, ka përbushur standardin e përcaktuar gjatë procedurave të arrestimit/ndalimit policor ku nëpër stacione të ndryshme policore si dhe në Qendrat e Mbajtjes nuk janë aplikuar, në të gjitha rastet, format unike të formularëve të arrestim ndalimit policor si dhe nuk ka pasur radhitje të këtyre formularëve ashtu siç është përcaktuar me Procedurën Standarde të Operimit (PSO-ZENDPO/133/10). Gjithashtu gjate kontrollimit të dosjeve të arrestim ndalimit policor, në pesëmbëdhjetë formularë nga A deri në O nuk janë plotësuar të gjitha hapësirat e përcaktuara.

1.4 Gjatë kontrollimit të formularit N-Aktvendimi mbi Ndalimin e personit të arrestuar në kuadër të objektivit të dytë, Mbikëqyrja, ka rezultuar se vetëm 78% të rasteve zyrtarët policor që kanë ardhur në rrethanë të arrestim ndalimit kanë shënuar identitetin e tyre në hapësirën e përcaktuar.

1.5 Kontrollimi i dosjeve të arrestim/ndalimit, në kuadër të objektivit të tretë mbi të drejtat personave të arrestuar, ka rezultuar se këto të drejta që janë të garantuara me Kodin e Procedurës Penale, janë realizuar në 87% të rasteve, në përjashtim të disa rasteve, ku formulari i cili parasheh këto të drejta ka pasur lëshime procedurale siç është nënshkrimi i këtij formulari nga ana e personit të arrestuar dhe e cila çështje ka vënë në dilema realizimin e të drejtave të personave të arrestuar. Edhe pse si përqindje është e lartë mirëpo ndjeshmëria e kësaj fushë bënë që ky rezultat nga Inspektorati Policor të konsiderohet si jo i kënaqshëm sepse kjo fushë duhet të ketë përbushje të plotë pa kurrfarë lëshimi.

1.6 Zyrtarët policor nëpër stacione policore dhe të gjitha njësitë tjera policore të cilët kanë ardhur në rrethana të arrestim ndalimit, si dhe zyrtarët e Qendrave të Mbajtjes kanë përbushur objektivin mbi detajet e arrestimit vetëm në masën 65% nga standardi i përcaktuar, në dosjet e kontrolluara në shumë raste ka munguar Aktvendimi mbi Lirimin e personit të arrestuar, arsyet e arrestimit nuk kanë qenë në përputhje me kriterin ligjor si dhe në disa raste nuk është dokumentuar se është bërë konfiskimi i pasurisë nga ana e personave të arrestuar.

1.7 Ndërsa gjatë kontrollimit të formularëve zyrtarët policor nëpër stacione dhe njësi të ndryshme policore të cilët kanë ardhur në rrethana të arrestim/ndalimit nuk kanë shënuar identitetin e prokurorit publik i cili është informuar lidhur me këtë çështje, ose në disa raste është shënuar emërtimi institucional i prokurorisë duke u ngatërruar me identitetin e prokurorit publik përkatës, dhe kjo ka ndodhur në 23% të rasteve të kontrolluara, kurse në 77% të rasteve të kontrolluara është shënuar identiteti i Prokurorit Publik.

1.8 Inspektorati Policor i Kosovës pas analizimit të të gjitha çështjeve që kanë dal pas inspektimit ka ardhur në përfundim se formularët e aplikueshëm nga A deri në O që shërbejnë për rastet e arrestim/ndalimit dhe që janë të bashkangjitura në PSO-ZENDPO/133/10, janë në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Ndërsa sa i përket zbatimit të këtyre çështjeve sipas procedurës së paraparë IPK ka evidentuar mangësi dhe lëshime të cilat janë të potencuar si të detajizuara në raport.

1.9 Duke u bazuar në rezultatet dhe të gjeturat gjatë inspektimit, Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon personelin përgjegjës brenda strukturës policore të PK-së, që të japin kontributin e tyre duke aplikuar mbikëqyrje të vazhdueshme tek stafi përgjegjës drejt përmirësimit të performancës policore, si dhe të sugjeroj apo të kërkoj organizime të trajnimeve adekuate për shtimin e njohurive në lëmin e procedurës së arrestim/ndalimit policor.

## 2. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM PËR HAPAT E NDËRMARRA GJATË INSPEKTIMIT

2.1 Ky inspektim është inspektim i rregullsisë dhe përputhshmërisë i cili përfshinë në vete një metodologji të re inspektimi dhe i cili me siguri që do të pasojë me inspektime të tjera me anë të të cilave do të verifikohet implementimi i rekomandimeve që do të dalin nga ky inspektim.

2.2 Gjatë rrjedhës së inspektimit, IPK fillimisht ka bërë analizimin e neneve të Kodit Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) me të cilët rregullohet fusha e arrestim- ndalimit, përfshirë edhe të drejtat e personave të arrestuar. Po ashtu është bërë analizimi i Parimeve dhe Procedurave të PK-së që rregullojnë fushën e arrestim- ndalimit, si dhe analizimi i përputhshmërisë së këtyre parimeve me Procedurë Standarde të Operimit në të cilën është përfshirë paketa e arrestimeve në Shtojcën 10- lidhur me përmbajtjen dhe plotësimin e formularëve prej A deri në O të cilat në total janë pesëmbëdhjetë formular. Gjithashtu janë kontrolluar të gjitha format që përmban dosja e arrestim- ndalimit, ku janë analizuar dhe janë krahasuar se a janë të gjitha format që kërkohen, a janë format ekzistuese në harmoni me politikat, si dhe a janë plotësuar të gjitha rubrikat që parashihen në këto forma.

2.3 Pas analizimeve të bëra është vërtetuar se Parimet dhe procedurat e PK-së, si dhe Procedura Standarde e Operimit, janë në përputhshmëri me kapitullin XXIV të KPPK-së ku si tematikë e rregullon fushën e arrestim- ndalimit.

2.4 Duke pasur parasysh që të gjithë personat e arrestuar dërgohen në Qendra të Mbajtjes ka bërë që ky inspektim të përfshijë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe punën e Qendrave të Mbajtjes por me fokus të veçantë në dosjet e arrestim- ndalimit.

2.5 Të gjeturat nga inspektimi kanë treguar një përqindje jo të kënaqshme të saktësisë ku nga pesë (5) objektivat asnjëra nga to nuk ka pasur rezultat maksimal në aspektin pozitiv . Mirëpo, kjo çështje nuk duhet të shihet si një shqetësim serioz për Policinë e Kosovës pasi që kjo është hera e parë që prej themelimit të kësaj organizate që inspektohet në fushën që kanë të bëjnë me dosjet e arrestimit-ndalimit dhe atë në këtë lloj metodologjie.

2.6 Duhet theksuar që në këtë raport tek detajet e të gjeturave në të gjithë objektivat dhe atë tek të gjitha dosjet –formularët nga A deri në O, faqet e raporteve janë të numerizuara nga ana e IPK-së, dhe kjo për shkak se formularët e arrestim- ndalimit të PK-së në përgjithësi nuk kanë pasur një radhitje të standardizuar sipas parimit.

### 3. HYRJE

3.1 Bazuar në Ligjin mbi Inspektoratin Policor të Kosovës Nr.03/1-231 neni 23,24 pika 2 dhe Planin Vjetor të Inspektimeve (2012), me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka zhvilluar një Inspektim të Rregullt që ka të bëjë me kontrollin dhe rishikimin e zbatimit të legjislacionit dhe procedurave në fuqi lidhur me Identifikimin dhe vlerësimin e procedurave të arrestim-ndalimit në Policinë e Kosovës.

3.2 Qëllimi i këtij inspektimi ishte kontrollimi dhe analizimi i të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me dosjet (formularët) e arrestim- ndalimit, në mënyrë që të përcaktohet përputhshmëria që ka të bëjë me zbatimin e ligjeve, procedurave dhe rregullave në fuqi që rregullojnë fushën e arrestim-ndalimit;

- Identifikimin dhe vlerësimin e procedurave të arrestimit
- Identifikimin dhe vlerësimin e përmbajtjes së formave zyrtare për arrestim
- Identifikimin dhe vlerësimin e zbatimit të procedurave të arrestimit në fuqi.

3.3 Objektivat e përcaktuara në këtë inspektim ishin ;

- Identifikimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë së procedurave të arrestim ndalimit në Policinë e Kosovës me KPPK.
- Identifikimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë së formave të procedurave të arrestim ndalimit në Policinë e Kosovës me KPPK.
- Identifikimi dhe zbatimi i procedurave të arrestim -ndalimit e që kanë të bëjnë me kompletimin dhe harmonizimin e formularëve që janë të përmbledhur në dosje të arrestim-ndalimit.
- Identifikimi dhe zbatimi i procedurave lidhur me mbikëqyrjen e përfilljes së procedurave të arrestim-ndalimit.
- Identifikimi dhe zbatimi i procedurave që kanë të bëjnë me përfilljen e të drejtave të personave të arrestuar.
- Identifikimi dhe zbatimi i procedurave rreth detajeve të arrestimit të përcaktuara në dosjet e arrestim-ndalimit.
- Si çështje tjetër e përcaktuar në objektiv është përcaktimi i së përgjithshmes i cili ka dal gjatë punës si rrjedhojë e çështjes e cila nuk është potencuar, por që është identifikuar gjatë inspektimit.

3.4 Rëndësia e këtij inspektimi qëndron në atë se arrestimi dhe ndalimi policor është një ndër fushat më të ndjeshme në punën policore ku kemi një përplasje të drejtpërdrejt në mes të

lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe autorizimeve policore në zbatimin e ligjit përfshirë këtu edhe përdorimin e forcës.

2.5 Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë Kodin e Procedurës Penale të Kosovës konkretisht nenet që rregullojnë çështjet e arrestim/ndalimit dhe PSO-në e Policisë së Kosovës e cila trajton mënyrën e procedimit, unifikimin e formularëve shoqërues, kushtet e ambientimit dhe akomodimin e personave të privuar nga liria (të ndaluar) në Qendrat e Mbajtjes, në territorin e Republikës së Kosovës me numër referues ZENDPO/133/10, e cila përveç tjerave në mënyrë të veçantë trajton mënyrën e procedimit dhe unifikimit të formularëve shoqërues që janë të lidhura direkt me personat e privuar nga liria (të ndaluar) në Qendrat e Mbajtjes, në territorin Republikës së Kosovës.

3.6 Në këtë procedurë të bashkangjitur gjenden dhe pesëmbëdhjetë formularët të cilët janë të radhitur në mënyrë alfabetike nga A deri në O. Nga këta pesëmbëdhjetë formularë dymbëdhjetë dhe atë prej A deri në L plotësohen nga zyrtarët policor në Qendrat e Mbajtjes, ndërsa tre formularët e fundit dhe atë M,N dhe O i plotësojnë të gjithë zyrtarët policor të cilët vijnë në rrethana të arrestim ndalimit të personave të dyshuar.

3.7 Në këtë inspektim si metodologji është përdorur metoda Randomizer- një algoritëm (metodë rasti) që përzgjedh numrat në mënyrë të paparashikueshme të paanshme dhe të pavarur- ku janë selektuar mostra zyrtare nga popullacioni prej gjithsej 4483 dosjeve të rasteve, dhe janë kontrolluar 106 dosje të rasteve të arrestim-ndalimit të përzgjedhura nga kjo metodë me një përzgjedhje të rrumbullakimit të madhësisë së mostrës në numrin më të përafërt të plotë ku janë përfshirë dosjet e arrestimit-ndalimit në njëzet e dy (22) Qendrat e Mbajtjes që kanë funksionuar në Policinë e Kosovës në vitin 2011, dhe atë në këto stacione policore të cekura si në vijim;

St. Qendra-Prishtinë, Drenas, Lipjan, Podujevë, Prizren, Dragash, Malishevë, Rahovec, Suharekë, Veriu-Mitrovicë,Skenderaj,Vushtrri,Leposaviq,Ferizaj, Pejë, Deçan, Gjakovë, Istog, Klinë, Gjilan, Kamenicë, dhe Viti.

3.8 Madhësia e mostrës është arritur me një testim prej 95% të saktësisë me lartësi të gabueshmërisë, plus- minus, deri në 5%. Mostra është përzgjedhur në periudhën kohore prej datës 01 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2011, dhe ka pasur për qëllim të përcaktojë përputhshmërinë e dosjeve të arrestim -ndalimit me standardet e përcaktuara nga objektivat.



## **4. PËRSHKRIMI I OBJEKTIVIT DHE TË GJETURAT**

### **4.1 Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të arrestim-ndalimit.**

4.1.1 Në kuadër të këtij inspektimi si qëllim i parë ishte identifikimi dhe vlerësimi i proceduarve të arrestimit/ndalimit ku pas analizimeve të bëra të dokumentacionit bazë është identifikuar dhe vlerësuar se Parimet dhe Procedurat e PK-së, si dhe Procedura Standarde e Operimit me numër referues ZENDPO/133/10 e cila ka të bashkangjitur në shtojcën A dhe pesëmbëdhjetë formularët, janë procedurat bazë të punës së Policisë së Kosovës dhe janë në përputhshmëri të plotë me kapitullin XXIV të KPPK-së ku si tematikë e rregullon fushën e arrestim- ndalimit.

4.1.2 Identifikimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë së procedurave të arrestim ndalimit në Policinë e Kosovës me KPPK, më konkretisht nenet KPPK-së 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 281 (i,ii,iii) që rregullojnë çështjet e arrestimit dhe ndalimit të përkohshëm dhe të drejtat e personave të arrestuar – ndaluar.

4.1.3 Në kuadër të strukturës Organizative të PK-së, Drejtoria e Përgjithshme për Operativë konkretisht Zyra Ekzekutive e Ndihmës Drejtorit të Përgjithshëm për Operative ne bazë të Strukturës Organizative të Policisë së Kosovës si dhe në përputhshmëri të kompetencave ligjore, përveç detyrave tjera që ka, gjithashtu është përgjegjëse që të hartojë procedura dhe politika për veprime të përgjithshme policore.

4.1.4 Kështu që më datë 16.12.2010 kjo drejtori ka aprovuar PSO-në e cila trajton mënyrën e procedimit, unifikimin e formularëve shoqërues, kushtet e ambientimit dhe akomodimin e personave të privuar nga liria (të ndaluar) në Qendrat e Mbajtjes, në territorin e Republikës së Kosovës me numër referues ZENDPO/133/10.

4.1.5 Në këtë procedurë të bashkangjitur gjenden dhe pesëmbëdhjetë formularët të cilët janë të radhitur në mënyrë alfabetike nga A deri në O. Nga këta pesëmbëdhjetë formularë dymbëdhjetë dhe atë prej A deri në L plotësohen nga zyrtarët policor në Qendrat e Mbajtjes, ndërsa tre formularët e fundit j M ,N dhe O i plotësojnë të gjithë zyrtarët policor të cilët vijnë në rrethana të arrestim ndalimit të personave të dyshuar.

### **4.2 Identifikimi dhe vlerësimi i përmbajtjes së formave zyrtare për arrestim**

4.2.1 Pasi që PSO-ja me numër referues ZENDPO/133/10 është identifikuar si procedurë pune cila rregullon çështjen e arrestim/ndalimit në Policinë e Kosovës dhe në kuadër të saj janë një mori formularësh të cilët duhet të përdoren nga zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës, Inspektorati Policorë i Kosovës si qëllim tjetër gjatë këtij inspektimi ka pasur identifikimin dhe vlerësimin e përmbajtjes së këtyre formularëve për të parë sa a përmbajnë të gjitha informatat e kërkuara për arrestim ndalim ashtu siç e parasheh KPPK-ja.

4.2.2 Gjatë analizimit të këtyre formularëve, Inspektorati Policorë i Kosovës ka gjetur se këta formularë përmbajnë informatat e kërkuara konform KPPK-së dhe në vazhdim do të paraqesim përmbajtjen e këtyre formularëve sipas renditjes alfabetike;

- (A) Shënimet e qendrës së mbajtjes,
- (B) Deklaratën për të ndaluarin në stacionin policor ose nga ndonjë zyrtar përgjegjës,
- (C) Të dhënat mbi arrestimin, kush ka bërë arrestimin, vendi, koha, stacioni etj,
- (D) Të drejtat e të ndaluarve,
- (E) Të drejtat kur i ndaluarit është shtetas i huaj dhe nën 18 vjeç,
- (F) Heqje dorë me shkrim nga e drejta për të pasur trup mbrojtës,
- (G) Përmban të dhënat lidhur me gjendjen shëndetësore,
- (H) Të dhënat mbi pronën me çka sqarohen gjerat që i merren përkohësisht të ndaluarit,
- (I) Faqe e kontaktit nr. 1
- (J) Faqe e kontaktit nr. 2
- (K) Formulari për lirim dhe transferimin,
- (L) Hapësira për të shkruar komente vetëm nga zyrtaret e qendrës së mbajtjes kur kjo është e nevojshme,
- (M) Të drejtat e personit të ndaluar, arsyeja e arrestit, koha, nënshkrimi i tij se ka kuptuar të drejtat dhe se merr një kopje,
- (N) Aktvendim mbi ndalimin e personit të arrestuar dhe
- (O) Aktvendim mbi lirim dhe personit të arrestuar.

#### **4.3 Identifikimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të arrestim- ndalimit**

4.3.1 Në kuadër të qëllimit të tretë që ka të bëjë me vlerësimin e zbatueshmërisë së këtyre formularëve në përputhje me procedurat e përcaktuara, Inspektorati Policor i Kosovës ka gjetur një përqindje jo të kënaqshme të saktësisë në zbatueshmërinë e këtyre procedurave të cilat janë potencuar në veçanti më poshtë.

4.3.2 Duhet theksuar që metoda e punës ka përcaktuar standardin sipas të cilit objektivat kanë ndërthurur në vete një pyetësor i cili ka parapa për secilin objektiv çështje -pyetje të veçanta të cilat dhe kanë përmbushur në tërësi objektivin.

##### **a) Të gjeturat në mënyrë të përgjithshme;**

###### **➤ Objektivi 1- Kompletimi dhe Harmonizimi**

Nga 106 dosjet e kontrolluara vetëm 32% kanë përmbushur standardin nga objektivi i përcaktuar.

###### **➤ Objektivi 2 - Mbikëqyrja**

Në objektivin e dytë që përfshinë mbikëqyrjen e formularëve nga 106 dosje të kontrolluara vetëm 78% prej tyre kanë qenë pozitive, më konkretisht e kanë plotësuar standardin e kërkuar.

###### **➤ Objektivi 3 - Të drejtat e personave të arrestuar**

Objektivi i tretë apo të drejtat e personave të arrestuar nga 106 formularët e dosjes që janë kontrolluar vetëm 87% prej tyre kanë qenë pozitive, apo në përputhje me standardin e kërkuar.

#### **Objektivi 4 - Detajet e arrestit**

Objektivi i katërt i cili është detajet e arrestit nga 106 dosjet e kontrolluara vetëm 65% prej tyre kanë qenë pozitive apo në përputhje me standardin e kërkuar.

#### **➤ Objektivi 5- E Përgjithshmja**

Dhe në objektivin e fundit i cili është përcaktuar si i përgjithshëm nga 106 dosjet e kontrolluara vetëm 77% prej tyre kanë qenë pozitive, apo kanë përmbushur standardin e kërkuar.

**Tab.1 Përmbledhja e të gjeturave të përgjithshme.**

<b>Nr. Objektivit</b>	<b>Përshkrimi i objektivit</b>	<b>Totali i raporteve të kontrolluara</b>	<b>Përmbledhja në përqindje sipas standardeve</b>
<b>1</b>	Kompletimi dhe Harmonizimi	106	<b>32%</b>
<b>2</b>	Mbikëqyrja	106	<b>78 %</b>
<b>3</b>	Përfillja procedurale tek të drejtat e personave të arrestuar	106	<b>87 %</b>
<b>4</b>	Detajet e arrestit	106	<b>65 %</b>
<b>5.</b>	E përgjithshmja	106	<b>77 %</b>

## b) Të gjeturat në mënyrë të detajizuar

### Objektivi 1-Kompletimi dhe Harmonizimi/ Kriteri

- **Kriteri;** Procedura Standarde e Operimit ZENDPO/133/10, e cila trajton mënyrën e përdorimit, unifikimin e formularëve shoqërues, kushtet e ambientit dhe akomodimin e personave të privuar nga liria(të ndaluar) në Qendrat e Mbajtjes, në territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu në këtë procedurë standarde të operimit është e paraqitur në mënyrë të harmonizuar dhe paketa e arrestimeve në Shtojcën 10- lidhur me përmbajtjen dhe plotësimin e formularëve prej A deri në O.
- **Procedura e inspektimit;** Është bërë kontrollimi i të gjithë formularëve që përshinë paketa e dosjes dhe janë verifikuar se;
  - ✓ A janë përdorur format e unifikuar sipas PSO-së ?
  - ✓ A është bërë plotësimi i këtyre formularëve konkretisht i të gjitha hapësirave në formularë sipas standardeve të kërkuara sipas PSO-së ?
  - ✓ A janë të radhitura format e kërkuara sipas standardeve të PSO-së ?
- **Të gjeturat;** Nga 106 dosjet e kontrolluara, 102 ( 96%)dosje të rasteve kanë përdorur format unike sipas PSO-së ndërsa 4 (4%) dosje nuk kanë përdorur forma unike sipas PSO-së. Nga 106 dosje të rasteve të kontrolluara asnjëra nga to, apo (0%) nuk kanë përmbushur të gjitha hapësirat me format e standardizuar nga PSO-ja, dhe nga 106 dosje të rasteve të arrestim/ndalimit asnjë dosje apo (0%) nuk kishte një radhitje të formave ashtu siç e parasheh PSO-ja.

Në 106 dosjet e kontrolluara përveç që ka pasur disa hapësira të cilat fare nuk janë plotësuar, ka pasur raste edhe kur ato janë plotësuar nuk kanë qenë në përputhshmëri me atë se çka është kërkuar të plotësohet. Po ashtu në këta formular ka pasur raste kur ata janë plotësuar por që gjatë analizimit është vërtetuar se plotësimi i njërës hapësirë më pastaj ka rezultuar me jo harmonizim të hapësirës tjetër.

#### REKOMANDIMI. NR 1

*Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Drejtorin e Policisë së Kosovës që sa më shpejt të autorizoj Drejtorinë e Përgjithshme për Operativë që të angazhohet në përmirësimin e kësaj gjendje duke kryer inspektime të brendshme të përdorimit, plotësimit dhe renditjes së duhur të këtyre formave në dosjet e rasteve të arrestim/ndalimit në të gjitha Qendrat e Mbajtjes, Stacionet Policore si dhe njësitet tjera policore në kuadër të Policisë së Kosovës, në mënyrë që të sigurohet se Policia e Kosovës do të veproj me formularë unik, të plotësuar saktë dhe të standardizuar në nivelin 100%.*

Tab.2 Objektivi 1, Kompletimi dhe Konsistenca

Nr.1	Qendrat e Mbajtjes	OBJEKTIVI 1, KOMPLETIMI DHE KONSISTENCA								
		A është përdor forma korrekte e unifikuar (komplete)			A është kompletuar forma (plotësimi i hapësirave)			A janë të radhitura format e kërkuara sipas standardeve të PSO-së		
		Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo
1	Prishtina	27	27	0	27	0	27	27	0	27
2	Drenasi	3	0	3	3	0	3	3	0	3
3	Lipjani	3	3	0	3	0	3	3	0	3
4	Podujeva	3	3	0	3	0	3	3	0	3
<b>I</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>36</b>	<b>33</b>	<b>3</b>	<b>36</b>	<b>0</b>	<b>36</b>	<b>36</b>	<b>0</b>	<b>36</b>
5	Prizreni	10	10	0	10	0	10	10	0	10
6	Dragashi	1	1	0	1	0	1	1	0	1
7	Malisheva	2	2	0	2	0	2	2	0	2
8	Rahoveci	2	2	0	2	0	2	2	0	2
9	Suhareka	3	3	0	3	0	3	3	0	3
<b>II</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>18</b>
10	Mitrovica V	3	3	0	3	0	3	3	0	3
11	Skenderaj	4	4	0	4	0	4	4	0	4
12	Vushtrri	6	6	0	6	0	6	6	0	6
13	Leposaviq	1	0	1	1	0	1	1	0	1
<b>III</b>	<b>Gjithësej</b>	<b>14</b>	<b>13</b>	<b>1</b>	<b>14</b>	<b>0</b>	<b>14</b>	<b>14</b>	<b>0</b>	<b>14</b>
14	Ferizaj	2	2	0	2	0	2	2	0	2
<b>IV</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>
15	Peja	7	7	0	7	0	7	7	0	7
16	Degani	2	2	0	2	0	2	2	0	2
17	Gjakova	9	9	0	9	0	9	9	0	9
18	Istogu	2	2	0	2	0	2	2	0	2
19	Klina	4	4	0	4	0	4	4	0	4
<b>V</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>0</b>	<b>24</b>	<b>0</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>0</b>	<b>24</b>
20	Gjilani	9	9	0	9	0	9	9	0	9
21	Kamenica	1	1	0	1	0	1	1	0	1
22	Vitia	2	2	0	2	0	2	2	0	2
<b>VI</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>12</b>
<b>Gjithsej:</b>		<b>106</b>	<b>102</b>	<b>4</b>	<b>106</b>	<b>0</b>	<b>106</b>	<b>106</b>	<b>0</b>	<b>106</b>
<b>Përqindja</b>		<b>100%</b>	<b>96%</b>	<b>4%</b>	<b>100%</b>	<b>0</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>0</b>	<b>100%</b>
<b>Totali pozitiv i zbatimit te Objektivit</b>		<b>32%</b>								

### 3.2.3 Objektivi 2- Mbikëqyrja

- **Kriteri;** Procedura Standarde e Operimit ZENDPO/133/10 , konkretisht formulari N-Aktvendimi mbi Ndalimin e personit të arrestuar, dhe formulari H- Të dhënat mbi pronën.
- **Procedura e inspektimit;** Në këtë objektiv është kontrolluar secila dosje ku në formularin Aktvendimi mbi Ndalimin e personit të arrestuar është verifikuar se;
  - ✓ a është nënshkruar zyrtari policor i cili ka bërë arrestimin - ndalimin në hapësirën përkatëse të formularit.
  - ✓ a është plotësuar hapësira në të cilën kërkohet numri identifikues dhe nënshkrimi i policit përcjellës si dëshmitarë gjatë kontrollimit të pronës ashtu edhe gjatë kthimit të saj me rastin e lirimit të personit të arrestuar- ndaluar.
- **Të gjeturat;** Nga 106 dosje të kontrolluara 100 apo (94%) prej tyre kanë qenë pozitive-janë nënshkruar nga zyrtari policor i cili ka bërë arrestimin - ndalimin në hapësirën përkatëse të formularit, më konkretisht e kanë plotësuar standardin e kërkuar, ndërsa 6 nga këto dosje të kontrolluara nuk është nënshkruar zyrtari policor që ka bërë arrestim-ndalimin.
- Ndërsa 39 (37%) prej 106 dosjeve të arrestimit nuk kanë përmbushur në përpikëri formën e standardizuar, nga objektivi i përcaktuar nuk kanë plotësuar hapësira në të cilën kërkohet numri identifikues dhe nënshkrimi i policit përcjellës si dëshmitarë gjatë kontrollimit të pronës ashtu edhe gjatë kthimit të saj me rastin e lirimit të personit të arrestuar- ndaluar, ndërsa në 67 (63%) raste ka qenë konform standardeve.

#### REKOMANDIMI. NR 2

*Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Drejtorin e Policisë së Kosovës që sa më shpejt të autorizoj Drejtorinë e Përgjithshme për Operativë që të angazhohet në përmirësimin e kësaj gjendje duke kryer inspektime të brendshme të përdorimit, plotësimit të formave H, dhe N te dosjet e rasteve të arrestim/ndalimit në të gjitha Qendrat e Mbajtjes, Stacionet Policore ku ka pasur raste ku nuk është evidentuar-nënshkruar zyrtari që ka kryer arrestin dhe zyrtari përcjellës si dëshmitarë gjatë kontrollimit të pronës ashtu edhe gjatë kthimit të saj me rastin e lirimit të personit të arrestuar- ndaluar, këto forma duhet të plotësuar saktë dhe ne nivelin 100% si dhe duhet te ketë një mbikëqyrje te rreptë.*

Tab.3 Objektivi 2, Mbikëqyrja

Nr.2	Qendrat e Mbajtjes	OBJEKTIVI 2, Mbikëqyrja					
		A është nënshkruar raporti nga zyrtari i cili e ka bërë arrestimin?			A është aprovuar dhe nënshkruar raporti nga polici përcjellës?		
		Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo
1	Prishtina	27	27	0	27	27	0
2	Drenasi	3	3	0	3	0	3
3	Lipjani	3	3	0	3	3	0
4	Podujeva	3	3	0	3	3	0
I	<b>Gjithsej</b>	<b>36</b>	<b>36</b>	<b>0</b>	<b>36</b>	<b>33</b>	<b>3</b>
5	Prizreni	10	10	0	10	10	0
6	Dragashi	1	1	0	1	1	0
7	Malisheva	2	2	0	2	2	0
8	Rahoveci	2	1	1	2	1	1
9	Suhareka	3	3	0	3	2	1
II	<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>	<b>17</b>	<b>1</b>	<b>18</b>	<b>16</b>	<b>2</b>
10	Mitrovica	3	0	3	3	0	3
11	Skenderaj	4	3	1	4	0	4
12	Vushtrri	6	5	1	6	1	5
13	Leposaviq	1	1	0	1	0	1
III	<b>Gjithsejt</b>	<b>14</b>	<b>9</b>	<b>5</b>	<b>14</b>	<b>1</b>	<b>13</b>
14	Ferizaj	2	2	0	2	1	1
IV	<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
15	Peja	7	7	0	7	2	5
16	Deqani	2	2	0	2	1	1
17	Gjakova	9	9	0	9	1	8
18	Istogu	2	2	0	2	0	2
19	Klina	4	4	0	4	2	2
V	<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>0</b>	<b>24</b>	<b>6</b>	<b>18</b>
20	Gjilani	9	9	0	9	9	0
21	Kamenica	1	1	0	1	1	0
22	Vitia	2	2	0	2	0	2
VI	<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>2</b>
<b>Gjithsej:</b>		<b>106</b>	<b>100</b>	<b>6</b>	<b>106</b>	<b>67</b>	<b>39</b>
<b>Përqindja</b>		<b>100%</b>	<b>94%</b>	<b>6%</b>	<b>100%</b>	<b>63%</b>	<b>37%</b>
<b>Totali pozitiv i zbatimit te Objektivit</b>		<b>78%</b>					

### 3.2.4 Objektivi 3- Te drejtat dhe çështjet procedurale të personave të arrestuar

- **Kriteri;** Të drejtat e personave të arrestuar të përcaktuar në KPPK <sup>1</sup>-së, si dhe procedura standarde e operimit ZENDPO/133/10 të bashkangjitur me shtojcën 10 të formularëve nga A deri në O.
- **Procedura e inspektimit;** Të gjitha dosjet janë kontrolluar dhe nga kjo është verifikuar se a është i bashkangjitur formulari për të drejtat e personave të arrestuar si dhe për më tutje është bërë verifikimi i leximit dhe aprovimi me shkrim nga ana e personave të arrestuar për kuptimin e këtyre të drejtave që ju takojnë duke verifikuar se;
  - ✓ A ka qenë i arrestuari i informuar mbi të drejtat?
  - ✓ A e ka nënshkruar i arrestuari se i ka kuptuar të drejtat e tij?
  - ✓ A është njoftuar personi i afërm i të arrestuarit?
  - ✓ A është nënshkruar zyrtari, cili e ka kontaktuar personin e afërm?
  - ✓ A është kontrolluar i arrestuari?
  - ✓ A është kryer kontrollimi nga një zyrtar i gjinisë së njëjtë?
  - ✓ A i është ofruar të arrestuarit ndihmë mjekësore?
  - ✓ A është përfshirë në paketën e arrestimit vendim mbajtje?
  - ✓ A është liruar personi i ndaluar/arrestuar brenda periudhës kohore të lejuar?
- **Të gjeturat;** Nga 106 dosjet e kontrolluara, 99 (93%) prej tyre kanë qenë pozitive sa i përket informimit të personave të arrestuar me të drejtat e tyre, kurse 6 prej dosjeve nuk kanë evidentuar dëshmi se personat e arrestuar janë informuar me të drejtat e tyre.
- Nga 106 dosje të kontrolluara, 101 (95%) prej tyre kanë qenë pozitive duke vërtetuar se personat e arrestuar i kane kuptuar të drejtat e tyre duke u nënshkruar në formularin konkret, deri sa 5 prej tyre nuk kanë pasur nënshkrimin e personit të arrestuar me të cilin gjë vihet në pikëpyetje kuptimi i këtyre të drejtave nga personat e arrestuar.
- Nga 106 dosje të kontrolluara, 74 (70%) prej tyre kanë qenë pozitive dhe kanë vërtetuar se janë informuar personat e afërm të personave të arrestuar, por që 32 (30%) prej dosjeve në formularin përkatës gjatë kontrollimit nuk ka pasur mundësi që të përcaktohet se a është bërë informimi i këtyre personave për shkak se ka pasur lëshime procedurale duke mos u shënuar identiteti i personit të afërm të personit të arrestuar.
- Nga 106 dosjet e kontrolluara, 79 (75%) prej tyre kanë qenë pozitive, ndërsa në 27 (25%) prej tyre konkretisht në formularin ku kërkohet të shënohet identiteti, numri identifikues si dhe nënshkrimi nga ana e zyrtarit policor i cili ka kontaktuar me personat e afërm të personit të arrestuar.
- Nga 106 dosje të kontrolluara, 97 (92%) prej tyre janë pozitive pra personat e arrestuar janë kontrolluar, kurse në 9 (8%) dosje nuk ka pasur ndonjë shënim në formular kështu që ka qenë e pamundur të përcaktohet se a është bërë kontrollimi i personave të arrestuar.
- Nga 106 dosje të kontrolluara, 83 (78%) prej tyre kanë qenë pozitive konkretisht kontrollimi i personave të arrestuar është bërë nga zyrtari policor i gjinisë së njëjtë, por

<sup>1</sup> KPPK neni 214 paragrafi 1 pika nga 1 deri në 6, neni 214 paragrafi 2



në 23 (22%) dosje ka qenë e pamundur të përcaktohet kjo çështje për shkak të lëshimeve procedurale duke mos u shënuar në formularin konkret identiteti i zyrtarit policor.

- Nga 106 dosje të kontrolluara, 69 (65%) prej tyre kanë qenë pozitive të cilat kanë vërtetuar se personave të arrestuar ju është ofruar ndihmë mjekësore, por në 37 (35%) dosje ka qenë e pamundur të përcaktohet ofrimi i ndihmës mjekësore për personat e arrestuar pasi që ka pasur jo harmonizim në plotësimin e formularit të gjendjes shëndetësore më konkretisht në qoftë se kërkesa e personit të arrestuar ka qenë pozitive për ndihmë mjekësore në pjesën tjetër nuk ka pasur ndonjë shënim për identitetin, nënshkrimin apo ndonjë licencë me të cilën do të vërtetohej se kjo e drejtë është realizuar.
- Nga 106 dosje të kontrolluara, 101 (95%) prej tyre kanë qenë pozitive duke përfshi në dosje formularin - Aktvendimin mbi ndalimin policor, ndërsa 4 (5%) prej dosjeve ju ka munguar ky formular.
- Nga 106 dosje të kontrolluara, 81 (76%) prej tyre kanë qenë pozitive dhe kanë vërtetuar se personat e arrestuar janë liruar brenda afatit ligjor, ndërsa në 25 (24%) dosje ka qenë e pamundur të përcaktohet kjo çështje për shkak se në dosje nuk ka qenë i bashkangjitur formulari Aktvendimi mbi lirimimin e personit të arrestuar.

Inspektorati Policor i Kosovës të gjeturat në kuadër të këtij objektivi i konsideron shqetësuese për shkak se këto lëshime procedurale nuk do të kontribuonin proceseve të mëtejme të cilat janë të ndërlidhura në mënyrë të drejtpërdrejt me këtë çështje.

Këto të gjetura tregojnë se Policia e Kosovës duhet të marr shumë seriozisht performancën e zyrtarëve të saj të cilët janë të angazhuar në zbatimin e autorizimeve të arrestim/ndalimit dhe përveç ngritjes së mbikëqyrjes të organizoj edhe trajnime të shpeshta rifreskuese lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut dhe plotësimin e formularëve sipas kërkesave të PSO-së në fuqi.

### REKOMANDIMI. NR 3

*Inspektorati Policor i Kosovës Rekomandon Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të angazhojë të gjithë komandantët e stacioneve policore, si dhe mbikëqyrësit e të gjitha njësive tjera në Policinë e Kosovës të rishikojnë të gjitha dosjet e arrestim ndalimit dhe të ndërmerren masat e duhura ndaj të gjitha parregullsive procedurale dhe të udhëzojnë të gjithë zyrtarët policor të cilët vijnë në rrethana të arrestimit-ndalimit të ndonjë personi të dyshuar, të përfillin pjesën procedurale të formularit M -Të drejtat e personit të arrestuar në mënyrë që të mos ketë dilema për tu vënë në diskutim realizimi i këtyre të drejtave, kjo procedure duhet te respektohet ne nivelin 100%.*

Tab.4 Objektiv 3- Te drejtat dhe çështjet procedurale të personave të arrestuar

Nr. 3	Qendra e Mbajtjes	A ka qenë arrestuari i informuar mbi të drejtat?			A e ka nënshkruar i arrestuari se i ka kuptuar të drejtat e tij?			A është njoftuar personi i afërm i të arrestuarit?			A është nënshkruar zyrtari, i cili e ka kontaktuar personin e afërm?			A është kontrolluar i arrestuari			A është kryer kontrollimi nga një zyrtar i gjinisë së njëjtë			A i është ofruar të arrestuarit ndihmë mjekësore			A është përfshirë në paketën e arrestimit vendimi mbi ndalimin			A është liruar i arrestuari brenda periudhës kohore të lejuar			
		Gj	Po	Jo	Gj	Po	Jo	Gj	Po	Jo	Gj	Po	Jo	Gj	Po	Jo	Gj	Po	Jo	Gj	Po	Jo	Gj	Po	Jo	Gj	Po	Jo	
1	Prishtina	27	27	0	27	27	0	27	27	0	27	27	0	27	27	0	27	27	0	27	27	0	27	27	0	27	27	0	
2	Drenasi	3	3	0	3	3	0	3	0	3	3	0	3	3	0	3	0	3	0	3	0	3	3	0	3	0	3		
3	Lipjani	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	2	1	3	3	0	3	3	0	
4	Podujeva	3	3	0	3	3	0	3	2	1	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	2	1	3	3	0	
I	<b>Gjithsej</b>	<b>36</b>	<b>36</b>	<b>0</b>	<b>36</b>	<b>36</b>	<b>0</b>	<b>36</b>	<b>32</b>	<b>4</b>	<b>36</b>	<b>33</b>	<b>3</b>	<b>36</b>	<b>33</b>	<b>3</b>	<b>36</b>	<b>33</b>	<b>3</b>	<b>36</b>	<b>32</b>	<b>4</b>	<b>36</b>	<b>35</b>	<b>1</b>	<b>36</b>	<b>33</b>	<b>3</b>	
5	Prizreni	10	10	0	10	10	0	10	10	0	10	10	0	10	10	0	10	10	0	10	9	1	10	10	0	10	9	1	
6	Dragashi	1	1	0	1	1	0	1	1	0	1	1	0	1	1	0	1	1	0	1	0	1	1	0	1	1	0		
7	Malisheva	2	1	0	2	2	0	2	2	0	2	2	0	2	2	0	2	2	0	2	0	2	2	0	2	2	0		
8	Rahoveci	2	1	0	2	1	1	2	1	1	2	2	0	2	2	0	2	2	0	2	1	1	2	2	0	2	1	1	
9	Suhareka	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	3	3	0	
II	<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>18</b>	<b>17</b>	<b>1</b>	<b>18</b>	<b>17</b>	<b>1</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>18</b>	<b>13</b>	<b>5</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>18</b>	<b>16</b>	<b>2</b>	
10	Mitrovica	3	3	0	3	3	0	3	0	3	3	2	1	3	3	0	3	3	0	3	2	1	3	3	0	3	0	3	
11	Skenderaj	4	4	0	4	3	1	4	2	2	4	0	4	4	4	0	4	0	4	4	1	3	4	3	1	4	1	3	
12	Vushtri	6	6	0	6	6	0	6	4	2	6	1	5	5	5	0	6	2	4	6	5	1	6	6	0	6	4	2	
13	Leposaviq	1	1	0	1	1	0	1	0	1	1	1	0	1	1	0	1	1	0	1	0	1	1	1	0	1	1	0	
III	<b>Gjithsej</b>	<b>14</b>	<b>14</b>	<b>0</b>	<b>14</b>	<b>13</b>	<b>1</b>	<b>14</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>14</b>	<b>4</b>	<b>10</b>	<b>14</b>	<b>14</b>	<b>0</b>	<b>14</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>14</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>14</b>	<b>13</b>	<b>1</b>	<b>14</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	
14	Ferizaj	2	2	0	2	2	0	2	1	1	2	1	1	2	2	0	2	1	1	2	0	2	2	0	2	2	0		
IV	<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>		
15	Peja	7	7	0	7	4	3	7	4	3	7	5	2	7	6	1	7	6	1	7	3	4	7	7	0	7	7	0	
16	Deçani	2	2	0	2	2	0	2	1	1	2	1	1	2	1	1	2	1	1	2	1	1	2	2	0	2	1	1	
17	Gjakova	9	5	4	9	9	0	9	2	7	9	2	7	9	8	1	9	2	7	9	2	7	9	7	2	9	2	7	
18	Istogu	2	2	0	2	2	0	2	0	2	2	1	1	2	1	1	2	1	1	2	1	1	2	1	1	2	1	1	
19	Klina	4	3	1	4	3	1	4	3	1	4	4	0	4	4	0	4	4	0	4	3	1	4	4	0	4	4	0	
V	<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>19</b>	<b>5</b>	<b>24</b>	<b>23</b>	<b>1</b>	<b>24</b>	<b>10</b>	<b>14</b>	<b>24</b>	<b>13</b>	<b>11</b>	<b>24</b>	<b>20</b>	<b>4</b>	<b>24</b>	<b>14</b>	<b>10</b>	<b>24</b>	<b>10</b>	<b>14</b>	<b>24</b>	<b>21</b>	<b>3</b>	<b>24</b>	<b>15</b>	<b>9</b>	
20	Gjilani	9	8	1	9	8	1	9	7	2	9	9	0	9	9	0	9	9	0	9	5	4	9	9	0	9	8	1	
21	Kamenica	1	0	1	1	0	1	1	0	1	1	0	1	1	0	1	1	0	1	0	1	1	1	0	1	1	0		
22	Vitia	2	2	0	2	2	0	2	1	1	2	1	1	2	1	1	2	1	1	2	1	1	2	2	0	2	0	2	
VI	<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>12</b>	<b>8</b>	<b>4</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>12</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>12</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>12</b>	<b>9</b>	<b>3</b>	
<b>Gjithsej:</b>		<b>106</b>	<b>99</b>	<b>7</b>	<b>106</b>	<b>101</b>	<b>5</b>	<b>106</b>	<b>74</b>	<b>32</b>	<b>106</b>	<b>79</b>	<b>27</b>	<b>106</b>	<b>97</b>	<b>9</b>	<b>106</b>	<b>83</b>	<b>23</b>	<b>106</b>	<b>69</b>	<b>37</b>	<b>106</b>	<b>101</b>	<b>5</b>	<b>106</b>	<b>81</b>	<b>25</b>	
<b>Përqindja</b>		<b>100</b>	<b>93</b>	<b>7</b>	<b>100</b>	<b>95</b>	<b>5%</b>	<b>100</b>	<b>70</b>	<b>30</b>	<b>100</b>	<b>75</b>	<b>25</b>	<b>100</b>	<b>92</b>	<b>8</b>	<b>100</b>	<b>78</b>	<b>22</b>	<b>100</b>	<b>65</b>	<b>25</b>	<b>100</b>	<b>95</b>	<b>5</b>	<b>100</b>	<b>76</b>	<b>24</b>	
<b>Totali pozitiv i zbatimit te Objektivit</b>		<b>87%</b>																											

### 3.2.5 Objektivi 4- Detajet e arrestit

- **Kriteri;** Privimi nga liria i personit të arrestuar bëhet nga ana e policisë por, që pa vonesë detyrohet ta dërgojë tek gjyqtari i procedurës paraprake për paraburgim, ku ndalimi nga ky nen nuk mund të kalojë më shumë se 48 orë nga koha e arrestimit, dhe policia është e obliguar ta liroi personin përveç nëse gjyqtari ka vendosur për paraburgimin, dhe që arrestimi duhet të përmbush kriteret e përcaktuara në KPPK, nenet 211,212 paragrafi 4, neni 281 (i,ii,iii). Po ashtu dhe procedura standarde e operimit ZENDPO/133/10 të bashkangjitur me shtojcën 10 të formularëve nga A deri në O.
- **Procedurat e inspektimit;** Çdo dosje e rastit është kontrolluar se;
  - ✓ A ka pasur të bashkangjitur Aktvendimin mbi Lirimin e personit të arrestuar , nëse i arrestuari është liruar ?
  - ✓ A ka dokumentuar raporti i arrestimit arsyen e arrestit ?
  - ✓ A ka dokumentuar raporti i arrestimit ndonjë pasuri të konfiskuar nga i arrestuari ?
- **Të gjeturat;** Nga 106 dosje të kontrolluara, 25 ( 24 %) kanë qenë pozitive më konkretisht dosjes së rastit ju ka bashkangjitur formulari Aktvendimi mbi Lirimin e personit të arrestuar, ndërsa 85 (76%) dosje nuk kanë pasur të bashkangjitur këtë formularë.
- Nga 106 dosje të kontrolluara 92 (87%) kanë qenë pozitive duke shënuar ne formularin konkret arsyet e arrestimit, ndërsa në 14 (13%) dosje ne disa raste nuk kanë shënuar fare arsyet e arrestit ose arsyet nuk kanë qenë në përputhshmëri me arsyet të cilat i ka përcaktuar KPPK-së.
- Nga 106 dosje të kontrolluara, 90 (85%) kanë qenë pozitive dhe në formularin të dhënat mbi pronën janë shënuar pasuritë që janë konfiskuar nga personi i arrestuar, ndërsa 16 (15%) në dosje ka pasur raste kur nuk ka qenë i bashkangjitur fare formulari të dhënat mbi pronën ose edhe kur ka ekzistuar nuk është plotësuar fare, pastaj ka pasur raste kur ka qenë e pamundur të përcaktohet se a është kryer një veprim i tillë për shkak të mungesës së nënshkrimit të personit të arrestuar.

#### REKOMANDIMI. NR 4

*Inspektorati Policor i Kosovës Rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të angazhojë të gjithë komandantët e stacioneve policore, si dhe mbikëqyrësit e të gjitha njësiave tjera në Policinë e Kosovës të udhëzojnë të gjithë zyrtarët policor të cilët vijnë në rrethana të arrestimit-ndalimit të ndonjë personi të dyshuar, të bashkëngjitin dhe plotësojnë formularin O-Aktvendimin mbi lirimin e personit të arrestuar në momentin kur do të ka kalojë afati ligjor prej dyzet e tetë orëve si dhe të jenë të vëmendshëm që të plotësojnë hapësirat për arsyetimin e arrestim-ndalimit në përputhshmëri me nenin 281 të KPPK-së, kjo procedurë duhet të plotësohet ne nivelin 100%.*

Tab.5 Objektivi 4, Detajet e arrestit

Nr.4	Qendrat e Mbajtjes	OBJEKTIVI 4, Detajet e arrestit								
		Nëse i arrestuari është liruar, ai është bashkangjitur vendim mbi lirim dosjes së rastit?			A e ka dokumentuar raporti i arrestit arsyen e arrestimit			A ka dokumentuar raporti i arrestimit ndonjë pasuri të konfiskuar nga i arrestuari?		
		Gjithsej	Po	jo	Gjithsej	po	jo	Gjithsej	Po	Jo
1	Prishtina	27	1	26	27	27	0	27	26	1
2	Drenasi	3	0	3	3	3	0	3	0	3
3	Lipjani	3	0	3	3	3	0	3	2	1
4	Podujeva	3	0	3	3	2	1	3	1	2
<b>I</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>36</b>	<b>1</b>	<b>35</b>	<b>36</b>	<b>35</b>	<b>1</b>	<b>36</b>	<b>29</b>	<b>7</b>
5	Prizreni	10	1	9	10	10	0	10	9	1
6	Dragashi	1	0	1	1	1	0	1	1	0
7	Malisheva	2	2	0	2	2	0	2	1	1
8	Rahoveci	2	0	2	2	2	0	2	0	2
9	Suhareka	3	1	2	3	3	0	3	3	0
<b>II</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>	<b>4</b>	<b>14</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>18</b>	<b>14</b>	<b>4</b>
10	Mitrovica V	3	1	2	3	3	0	3	3	0
11	Skenderaj	4	1	3	4	3	1	4	4	0
12	Vushtrri	6	3	3	6	5	1	6	6	0
13	Leposaviq	1	0	1	1	1	0	1	1	0
<b>III</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>14</b>	<b>5</b>	<b>9</b>	<b>14</b>	<b>12</b>	<b>2</b>	<b>14</b>	<b>14</b>	<b>0</b>
14	Ferizaj	2	0	2	2	2	0	2	2	0
<b>IV</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>
15	Peja	7	6	1	7	5	2	7	7	0
16	Deçani	2	1	1	2	1	1	2	2	0
17	Gjakova	9	2	7	9	4	5	9	8	1
18	Istogu	2	1	1	2	1	1	2	2	0
19	Klina	4	4	0	4	4	0	4	4	0
<b>V</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>14</b>	<b>10</b>	<b>24</b>	<b>15</b>	<b>9</b>	<b>24</b>	<b>23</b>	<b>1</b>
20	Gjilani	9	0	9	9	8	1	9	7	2
21	Kamenica	1	1	0	1	0	1	1	0	1
22	Vitia	2	0	2	2	2	0	2	1	1
<b>VI</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>11</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>12</b>	<b>8</b>	<b>4</b>
<b>Gjithsej</b>		<b>106</b>	<b>25</b>	<b>81</b>	<b>106</b>	<b>92</b>	<b>14</b>	<b>106</b>	<b>90</b>	<b>16</b>
<b>Përqindja</b>		<b>100%</b>	<b>24%</b>	<b>76%</b>	<b>100%</b>	<b>87%</b>	<b>13%</b>	<b>100%</b>	<b>85%</b>	<b>15%</b>
<b>Totali pozitiv i zbatimit të zbatimit të Objektivit</b>		<b>65%</b>								

### 3.2.6 Objektivi 5- E përgjithshmja

- **Kriteri;** Sipas KPPK KPPK nenet 211 paragrafi 2 dhe neni 219 paragrafi 1 pika 9, arrestim- ndalimi i bërë nga policia autorizohet nga prokurori publik, ose kur për shkak të rrethanave të ngutshme autorizimi i tillë nuk mund të merret para arrestimit policia menjëherë duhet të informojë prokurorin publik pas arrestimit, si dhe në dosje të saj policia mban shënime për çdo veprim të saj duke përfshirë dhe identitetin e zyrtarit policor apo prokurorit publik përkatës.
- **Procedura e inspektimit;** Në të gjitha dosjet e kontrolluara tek formulari për Aktvendimin e ndalimit të personit të arrestuar- ndaluar në hapësirën përkatëse është verifikuar se:
  - ✓ A është shënuar identiteti i prokurorit publik i cili ka autorizuar arrestim - ndalimin e personit ?
- **Të gjeturat;** Në objektivin e fundit i cili është përcaktuar si i përgjithshëm nga 106 dosjet e kontrolluara, 82 (77%) prej tyre kanë qenë pozitive, apo kanë përmbushur standardin e kërkuar, pra, është shënuar identiteti i prokurorit publik i cili ka autorizuar arrestim - ndalimin e personit. Ndërsa 24 (23%) dosje të arrestimit nuk kanë përmbushur në përpikëri formën e standardizuar nga objektivi i përcaktuar duke mos shënuar identitetin e prokurorit publik apo kjo çështje është ngatërruar duke shënuar emërtimin e prokurorisë përkatëse.

Ky objektivi është identifikuar pas procesit planifikues dhe është trajtuar si çështje gjatë punës ku është vërejtur se në objektivat paraprak nuk ka pasur ndonjë pyetje që e ka trajtuar çështjen e identitetit të prokurorit publik përkatës andaj dhe ky objektivi është emërtuar si E Përgjithshmja (Gjithëpërfshirja).

#### REKOMANDIMI. NR 5

*Inspektorati Policor i Kosovës Rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të angazhojë të gjithë komandantët e stacioneve policore, si dhe mbikëqyrësit e të gjitha njësive tjera në Policinë e Kosovës të udhëzojnë të gjithë zyrtarët policor të cilët vijnë në rrethana të arrestimit-ndalimit të ndonjë personi të dyshuar në hapësira të formularit përkatës të shënojnë identitetin e prokurorit publik përkatës i cili ka autorizuar arrestim-ndalimin, kjo procedure duhet te plotësohet ne nivelin 100%.*

Tab.6 Objektivi 5- E Përgjithshme

Nr.5	Qendrat e Mbajtjes	OBJEKTIVI 5 E Përgjithshme A është shënuar identiteti i prokurorit publik i cili ka autorizuar arrestim -ndalimin e personit ?		
		Gjithsej	Po	Jo
1	Prishtina	27	27	0
2	Drenasi	3	3	0
3	Lipjani	3	3	0
4	Podujeva	3	2	1
I	<b>Gjithsej</b>	<b>36</b>	<b>36</b>	<b>0</b>
5	Prizreni	10	4	6
6	Dragashi	1	0	1
7	Malisheva	2	0	2
8	Rahoveci	2	1	1
9	Suhareka	3	2	1
II	<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>	<b>7</b>	<b>11</b>
10	Mitrovica	3	1	2
11	Skenderaj	4	3	1
12	Vushtrri	6	3	3
13	Leposaviq	1	0	1
III	<b>Gjithsej</b>	<b>14</b>	<b>7</b>	<b>7</b>
14	Ferizaj	2	2	0
IV	<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>
15	Peja	7	3	4
16	Deqani	2	2	0
17	Gjakova	9	8	1
18	Istogu	2	1	1
19	Klina	4	4	0
V	<b>Gjithsej</b>	<b>24</b>	<b>18</b>	<b>6</b>
20	Gjilani	9	9	0
21	Kamenica	1	1	0
22	Vitia	2	2	0
VI	<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>0</b>
<b>Gjithsej:</b>		<b>106</b>	<b>82</b>	<b>24</b>
<b>Përqindja</b>		<b>100%</b>	<b>77%</b>	<b>23%</b>
<b>Totali pozitiv i zbatimit te Objektivit</b>		<b>77%</b>		

## 5. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

### 5.1 Përfundime

4.1.1 Duke u bazuar në të gjeturat që kanë përfshi objektivin e parë dhe që ka pasur të bëjë me identifikimin dhe vlerësimin e procedurave të arrestim - ndalimit, Inspektorati Policor i Kosovës ka konstatuar se procedura e arrestim ndalimit me të gjitha formularët e bashkangjitur në shtojcën 10 janë në përputhshmëri të plotë me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës konkretisht me nenet që rregullojnë fushën e arrestim-ndalimit.

4.1.2 Zyrtarët policor nëpër stacione policore dhe të gjitha njësitë tjera policore të cilët kanë ardhur në rrethana të arrestim ndalimit, duke u bazuar në PSO-ZENDPO/133/10 të bashkangjitur me shtojcën 10 të formularëve nga A deri në O, gjatë përmbushjes së detyrave të tyre procedurale në formularët konkret që janë plotësuar nga ta, në disa raste kanë përdorur forma jo unike dhe të pa harmonizuara me këtë PSO.

4.1.3 Zyrtarët policor në Qendrat e Mbajtjes gjatë plotësimit të formularëve nuk kanë bërë radhitjen e duhur të formularëve të cilët janë të përcaktuar sipas PSO-it, si dhe kanë ngatërruar plotësimet e hapësirave duke bërë ndërrime të tyre në kontekst mes njëra tjetres. Gjithashtu në disa raste këto janë plotësuar pa e kuptuar përmbajtjen e kërkuar në hapësirë.

4.1.4 Zyrtarët policor nëpër stacione policore dhe të gjitha njësitë tjera policore të cilët kanë ardhur në rrethana të arrestim ndalimit në përputhje me PSO-ZENDPO/133/10 të bashkangjitur me shtojcën 10 të formularëve nga A deri në O, gati se në të gjitha rastet kanë bashkangjitur formularin mbi leximin e te drejtave të personit të arrestuar, por që në disa raste ky formular ka pasur lëshime procedurale të cilat kanë vënë në dilema realizimin e te drejtave të personave të arrestuar.

4.1.5 Zyrtarët policor nëpër stacione policore dhe të gjitha njësitë tjera policore të cilët kanë ardhur në rrethana të arrestim ndalimi në përputhje me PSO-ZENDPO/133/10 të bashkangjitur me shtojcën 10 të formularëve Aktvendimin mbi ndalimin e personit të arrestuar (formulari N) nuk kanë shënuar identitetin e zyrtarit policor të autorizuar. Po ashtu zyrtarët policor në Qendrat e Mbajtjes gjatë plotësimit të formularit të dhënat mbi pronën e personit të arrestuar gjatë kontrollimit të saj nuk e kanë vërtetuar këtë gjë edhe nga ana e një polici tjetër përcjellës goftë me shënimet e numrit identifikues ashtu dhe me nënshkrimet e tyre.

4.1.6 Zyrtarët policor nëpër stacione policore dhe të gjitha njësitë tjera policore të cilët kanë ardhur në rrethana të arrestim ndalimit, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës në formularin përkatës nuk kanë shënuar identitetin e prokurorit publik, dhe në disa raste tjera e kanë ngatërruar plotësimin në çështje përmbajtjesore duke shënuar emërtimin institucional të prokurorive.

## 5.2 Rekomandimet

1. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Drejtorin e Policisë së Kosovës që sa më shpejt të autorizoj Drejtorinë e Përgjithshme për Operativë që të angazhohet në përmirësimin e kësaj gjendje duke kryer inspektime të brendshme të përdorimit, plotësimit dhe renditjes së duhur të këtyre formave në dosjet e rasteve të arrestim/ndalimit në të gjitha Qendrat e Mbajtjes, Stacionet Policore si dhe njësitet tjera policore në kuadër të Policisë së Kosovës, në mënyrë që të sigurohet se Policia e Kosovës do të veproj me formularë unik, të plotësuar saktë dhe të standardizuar ne nivelin 100%.*
2. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Drejtorin e Policisë së Kosovës që sa më shpejt të autorizoj Drejtorinë e Përgjithshme për Operativë që të angazhohet në përmirësimin e kësaj gjendje duke kryer inspektime të brendshme të përdorimit, plotësimit të formave H, dhe N të dosjet e rasteve të arrestim/ndalimit në të gjitha Qendrat e Mbajtjes, Stacionet Policore ku ka pasur raste ku nuk është evidentuar-nënshkruar zyrtari që ka kryer arrestin dhe zyrtari përcjellës si dëshmitarë gjatë kontrollimit të pronës ashtu edhe gjatë kthimit të saj me rastin e lirit të personit të arrestuar- ndaluar, këto forma duhet të plotësuar saktë dhe ne nivelin 100% si dhe duhet te ketë një mbikëqyrje te rreptë.*
3. *Inspektorati Policor i Kosovës Rekomandon Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të angazhojë të gjithë komandantët e stacioneve policore, si dhe mbikëqyrësit e të gjitha njësite tjera në Policinë e Kosovës të rishikojnë të gjitha dosjet e arrestim ndalimit dhe të ndërmerren masat e duhura ndaj të gjitha parregullsive procedurale dhe të udhëzojnë të gjithë zyrtarët policor të cilët vijnë në rrethana të arrestimit-ndalimit të ndonjë personi të dyshuar, të përfillin pjesën procedurale të formularit M -Të drejtat e personit të arrestuar në mënyrë që të mos ketë dilema për tu vënë në diskutim realizimi i këtyre të drejtave, kjo procedure duhet te respektohet ne nivelin 100%.*
4. *Inspektorati Policor i Kosovës Rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të angazhojë të gjithë komandantët e stacioneve policore, si dhe mbikëqyrësit e të gjitha njësite tjera në Policinë e Kosovës të udhëzojnë të gjithë zyrtarët policor të cilët vijnë në rrethana të arrestimit-ndalimit të ndonjë personi të dyshuar, të bashkëngjitin dhe plotësojnë formularin O-Aktvendimin mbi lirimin e personit të arrestuar në momentin kur do të ka kalojë afati ligjor prej dyzet e tetë orëve si dhe të jenë të vëmendshëm që të plotësojnë hapësirat për arsyetimin e arrestim-ndalimit në përputhshmëri me nenin 281 të KPPK-së, kjo procedurë duhet të plotësohet ne nivelin 100%.*
5. *Inspektorati Policor i Kosovës Rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të angazhojë të gjithë komandantët e stacioneve policore, si dhe mbikëqyrësit e të gjitha njësite tjera në Policinë e Kosovës të udhëzojnë të gjithë zyrtarët policor të cilët vijnë në rrethana të arrestimit-ndalimit të ndonjë personi të dyshuar në hapësira të formularit përkatës të shënojnë identitetin e prokurorit publik përkatës i cili ka autorizuar arrestim-ndalimin, kjo procedure duhet te plotësohet ne nivelin 100%.*